



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01Nr. 112102-21428
Datë: 30.10.2023

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 7, 11, 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 4, 5 të Statutit të Komunës së Gjakovës me numër 110/04-29365, nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-054 për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2009 për Vulën Rrethore dhe dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.03/2009 për Formën e Vulës Katrore si dhe Llojin, Nuancat dhe Parametrat Teknikë të ngjyrës së Vulës Katrore, me datë 30.10.2023, e mori këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për fillimin e procedurave për marrjen e lejes për ndërrimin e vulave dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të tjera të parapara me ligj, në këtë përbërje:

- 1.1. Artan Hoxha, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Frrok Gjergjaj, anëtar;
- 1.3. Selman Sahiti, anëtar;

2. Komisioni do të filloj punën në zhvillimin e procedurës për marrjen e lejes për ndërrimin e vulave rrethore dhe ato katrore për organet e administratës, siç janë:

- Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa;
- Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport –Teatri i Qytetit “Hadi Shehu”
- Njësia e Prokurimit;
- Sektori për përfaqësim Ligjor;

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Vendimi i'u dërgohet:

- Kabinetit të Kryetarit të Komunës;
- Anëtarëve të komisionit;
- Arkivit.

Kryetari i Komunës së Gjakovës

